



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E APELIT  
TIRANE

Adresa: Gjykata e Apelit Tiranë, Bulevardi " Zhan Dark " Nr. 33, Hyrja 1, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.  
www.gjykataapelittirane.al, Email:info@gjykataapelittirane.al, Tel: +35542260496, Fax: + 35542260284

Nr. 158 Prot.

Tiranë, më 23.07.2015

V E N D I M

**“Mbi plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e 11 çështjeve penale - masa sigurimi personal datë 23.07.2015”**

Në mbështetje të Ligjit nr. Nr.9877, datë 18.2.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18 pika 3/c, Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, i ndryshuar me vendimin nr. 282.8, datë 16.12.2011, Vendimit nr. 209 Prot., datë 16.12.2014 dhe Vendimit nr. 123 Prot, datë 11.05.2015 të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë; si dhe

duke marrë në konsideratë:

- **Kërkesën me shkrim datë 23.07.2015 të Gjyqtarës Edlira Petri (caktuar si gjyqtare e gatshme për gjykimin masave të sigurimit personal me Vendimin nr. 209 Prot., datë 16.12.2014 të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë) me anë të së cilës i ka kërkuar Kryetarit të Gjykatës plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e 11 çështjeve penale masa sigurimi personal, pasi tre gjyqtarët Hysni Demiraj, Gjini Gjoni dhe Metush Saraci, kanë refuzuar të marrin pjesë në përbërjen e trupit gjykues për gjykimin e këtyre çështjeve, duke parashtruar si shkak angazhimin e tyre në çështjet civile të planifikuara më parë prej tyre.**

- **Faktin që ky refuzim i këtyre gjyqtarëve bëhet në shkelje të Vendimit nr. 123 Prot, datë 11.05.2015 të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë në të cilin është vendosur që gjyqtarja Edlira Petri do të gjykojë me Kolegjin Civil të përbërë nga tre gjyqtarët Hysni Demiraj, Gjini Gjoni dhe Metush Saraci, si dhe në shkelje të Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, i ndryshuar, ku në nenin 6 parashikohet se: “Kryetari i gjykatës, ndan gjyqtarët në dhomat e gjykimit në fushën civile dhe penale si edhe për sa është e mundur, seksionet përkatëse familjare, tregtare dhe administrative brenda dhomës civile. Në rastin kur një prej anëtarëve të trupit gjykues vlerësohet se ka një shkak për përjashtim ose është në pamundësi të përkohshme paraqitjeje, plotësimi i trupit gjykues, bëhet me caktimin në vend të tij të një gjyqtari tjetër, me përzgjedhje nga kryetari i gjykatës. Në**

*përzgjedhjen me short të gjyqtarit, kryetari i gjykatës, mban parasysht një trajtim të njëjtë mes gjyqtarëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit dhe seksionin përkatës.”*

*- Natyrën urgjente që karakterizon gjykimin e masave të sigurimit personal dhe **pasojat e rënda** që mund të sjellin vonesat në gjykimin e çështjeve të këtij lloji, që kanë të bëjnë me lirin e personave nën hetim për vepra të rënda penale, në kundërshtim me Kushtetutën, Kodin e Procedurës Penale (neni 249/5) dhe legjislacionin në fuqi të RSH;*

#### **Vendosa:**

1. Plotësimin e trupit gjykues të kryesuar nga gjyqtare Edlira Petri, nga gjyqtarë që rezultojnë të lirë, për gjykimin e 11 çështjeve penale masa sigurimi personal, të planifikuara për t'u gjykuar datë 23.07.2015 .
2. Ky vendim t'i bashkëlidhet praktikës përkatëse dhe t'i përcillet për informacion Inspektoriatit të KLD.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të gjykatës.

